

VENDIM
Nr. 903, datë 11.11.2015

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KORESË,
PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Koresë, për bashkëpunimin ekonomik, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KORESË MBI BASHKËPUNIMIN EKONOMIK**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Koresë (më poshtë të referuara si “Palët”),

duke aspiruar për të vazhduar dhe konsoliduar miqësinë dhe bashkëpunimin e tyre historik;

duke dëshiruar të forcojnë më tej marrëdhëniet ekonomike ndërmjet dy shteteve mbi parimet e përfitimit reciprok,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët do të përpiqen të zhvillojnë dhe të forcojnë zgjerimin dhe rritjen e bashkëpunimit ekonomik të favorshëm reciprokisht në fusha të lidhura me zhvillimin ekonomik dhe social, në përputhje me ligjet përkatëse kombëtare dhe rregulloret e dy shteteve.

Neni 2

Palët, duke marrë në konsideratë situatën aktuale në marrëdhëniet e tyre ekonomike, do të përpiqen të krijojnë kushte të favorshme reciprokisht për bashkëpunim afatgjatë në fushat e mëposhtme:

- a) bujqësi dhe peshkim;
- b) prodhim;
- c) energji dhe industri minerale;
- d) ndërmarrje të vogla dhe të mesme;
- e) teknologji informacioni dhe komunikimi;
- f) zhvillim ekonomik;
- g) shkencë dhe teknologji;
- h) turizëm;
- i) transport dhe logjistikë;
- j) mjedis; dhe
- k) fusha të tjera të interesit të përbashkët për të cilat mund të bihet dakord ndërmjet palëve.

Neni 3

Format e bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje mund të përfshijnë:

- a) Nxitjen e personave juridikë dhe individëve të dy shteteve për të eksploruar mundësitë e zbatimit të projekteve të përbashkëta në fushat e mësipërme të bashkëpunimit;
- b) Nxitjen e shkëmbimit të ekspertëve, shkencë-tarëve, teknikëve, studentëve dhe stazhierëve në fushat e mësipërme të bashkëpunimit;
- c) Nxitjen e pjesëmarrjes së personave juridikë dhe individëve të dy shteteve në panairë dhe ekspozita ndërkombëtare të organizuara në të dyja shtetet; dhe
- d) Çdo formë tjetër bashkëpunimi për të cilën mund të bihet dakord nga Palët.

Neni 4

1. Për të lehtësuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, palët do të krijojnë një komision të përbashkët.
2. Komisioni i përbashkët do të përbëhet kryesisht nga përfaqësuesit e Palëve.
3. Komisioni i përbashkët do të kryejë aktivitetet e mëposhtme:
 - a) Diskutimin e bashkëpunimit ekonomik dypalësh;
 - b) Mbështetjen e bashkëpunimit të referuar në nenet 2 dhe 3;
 - c) Shqyrtimin dhe vlerësimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje; dhe
 - d) Çdo aktivitet tjetër bashkëpunues për të cilin mund të bihet dakord nga palët.
4. Komisioni i Përbashkët do të mbahet në mënyrë alternative në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Koresë, periodikisht ose me kërkesë të njëres prej Palëve dhe me pranimin e Palës tjetër.
5. Masat e veçanta zbatuese që përcaktojnë detajet dhe procedurat e aktiviteteve specifike të bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje, duke ndjekur rekomandimet e bëra nga Komisioni i Përbashkët, mund të vendosen në përputhje me ligjet përkatëse kombëtare dhe rregulloret e të dy shteteve.

Neni 5

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e Palëve që lindin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare në të cilat ato janë palë.

Neni 6

Çdo konflikt që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet këshillimeve të përbashkëta ndërmjet Palëve.

Neni 7

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me miratimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve.

Neni 8

1. Secila Palë do të njoftojë me shkrim Palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike mbi përfundimin e procedurave të saj të brendshme të kërkuara për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga Palët të njoftimit të fundit.

2. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë fillestare prej 5 (pesë) vitesh dhe do të rinovohet më pas automatikisht për periudha pasuese prej 5 (pesë) vitesh, nëse njëra prej Palëve nuk njofton Palën tjetër me shkrim të paktën 6 (gjashtë) muaj nëpërmjet kanaleve diplomatike, në lidhje me synimin e saj për të përfunduar këtë Marrëveshje.

3. Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të cenojë vlefshmërinë ose kohëzgjatjen e aktiviteteve të bashkëpunimit të ndërmarra sipas kësaj Marrëveshjeje dhe të papërfunduara ende në kohën e përfundimit të saj nëse nuk bihet dakord bashkërisht nëpërmjet Palëve.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar siç duhet nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

E bërë në dy kopje, në Nju-Jork, më 29 shtator 2015, në gjuhën shqipe, koreane dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike.

Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.